

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Ujësjetës Kanalizime Durrës Sh.a

Durrës, 07/11/2018

“Përmirësim i furnizimit me ujë fshati Koxhas, Nj.Adm Xhafzotaj, Bashkia Shijak”

Për: **“KRONOS KONSTRUKSION ” sh.p.k** Nipt K41416033P me adresë: Rruga “Bulevardi Gjergj Fishta,, Prane ish ekspozites Shqiperia Sot, Tirane.

Proçedura e prokurimit: “Proçedurë e hapur-pune”

Numri i references se procedures/lotit: **84919-09-07-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti: **“Përmirësim i furnizimit me ujë fshati Koxhas, Nj.Adm Xhafzotaj, Bashkia Shijak”**

- Fondi limit: **12.297.378** (dymbëdhjete milion e dyqind e nentëdhjete e shtate mije e treiqind e shtatëdhjete e tete) lekë pa TVSH
- Burimi i te ardhurave: Te ardhurat e U.K.D Sh.a
- Kohezgjatja e kontrates: **30 ditë nga lidhja e kontratës**
- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në proçedure 5(pese) Operatorë Ekonomik si me poshte:

1. **“2AF ALBANIA GROUP” sh.p.k** me nipt L32005501M dhe **“ALB LEAA INTERNATIONAL” sh.p.k,** me nipt J86906408N, me vlere te ofruar:
 - pa TVSH **12’061’775** (dymbëdhjete milion e gjashtëdhjete e nje mije e shtateqind e shtatëdhjete e pese) leke.
 - me TVSH **14’474’130** (katermbëdhjete milion e katerqind e shtatëdhjete e kater mije e njeqind e tridhjete) leke.
2. **“ALEN-CO ” sh.p.k,** me nipt K83213401M, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.
3. **“AL-ASFALT” sh.p.k,** me nipt K81511508A, me vlere te ofruar:
 - pa TVSH **12’000’000** (dymbëdhjete milion) leke.
 - me TVSH **14’399’999** (Katermbëdhjete milion e treqind e nentëdhjete e nente

mije e nentëqind e nentëdhjetë e nente) leke.

4. **“KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k** me Nipt K41416033P, me vlerë të ofruar:

- **pa TVSH 11’937’513,5** (njëmbëdhjetë milion e nentëqind e treidhjetë e shtatë mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje pese) leke.
- **me TVSH 14’325’016,2** (katërmëdhjetë milion e treqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëmbëdhjetë presje dy) leke.

5. **“Liqeni VII” shpk**, me nipt K01730502W, me vlerë të ofruar:

- **pa TVSH 11’982’050,33** (njëmbëdhjetë milion e nentëqind e treidhjetë e shtatë mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje pese) leke.
- **me TVSH 14’378’460,39** (katërmëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë presje tridhjetë e nente) leke.

Skualifikohen operatorët ekonomik si me poshtë:

1. Operatori Ekonomik **“AL-ASFALT” shpk** është skualifikuar për arsye se:

- Kriteret e Vecanta të Kualifikimit

Kapaciteti Teknik

Pika 3. Çertifikatat ISO 9001-2008 dhe ISO 14001-2004 nuk janë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Pika 4. Nuk ka paraqitur Listapagesat për periudhën Janar-Gusht 2018.

Pika 4.a Inxhinieri gjeodet, për të cilin është paraqitur dokumentacioni përkatës, nuk ndodhet në Licencën e Shoqërisë.

Pika 4.c Nuk ka kontakte për specialistin e kualifikuar “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”

Pika 5. Nuk ka paraqitur dokumenta për trencher me vakum për hapje kanali, aparat saldimi tubo PE, 2 fadromat janë vetëm me fature zhdoganimit, nuk kanë dokumentat përkatëse si leje qarkullimi, taksa, sigurancë, certifikatë të kontrollit teknik etj. , 2 betonieret, gjeneratorët, vibratorët dhe një eskavator janë me fature zhdoganimit në emër të AV Konstruksion.

Pika 7. Deklarata në Shtojcën 11. nuk është sipas formatit të kërkuar në DST

2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik **“2AF ALBANIA GROUP” sh.p.k** dhe **“ALB LEAA INTERNATIONAL” sh.p.k** është skualifikuar për arsye se :

- Kriteret e Vecanta të Kualifikimit

Kapaciteti Teknik

Pika 5. Në deklaratën Mbi Disponimin e Makinerive nuk ka paraqitur asfaloshtuese, Eskavatori me goma me targë DR6302D i është dhënë me qera për 3 vjet subjektit “Liqeni VII”, pompa uji ka paraqitur 1 nga 2 të kërkuara.

Pika 6. Autorizimi i prodhuesit është vetëm për tuba HDPE RC ndërkohe në DST është kërkuar edhe për rakorderite.

3. Operatori Ekonomik **“LIQENI VII ” sh.p.k** është skualifikuar për arsye se:

- Kriteret e Vecanta të Kualifikimit

Kapaciteti Teknik

Pika 4.d Ka paraqitur dokumenta për 2 hidraulike nga 5 të kërkuar.

Pika 5. Fatura e zhdoganimit që është paraqitur për trencher me vakum shkruan eskavator me zinxhirre.

Operatori Ekonomik **“ALEN-CO”sh.p.k** nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik **“KRONOS KONSTRUKSION ” sh.p.k** vlerësohet i rregullt.

Pra Operatori Ekonomik **“KRONOS KONSTRUKSION ” sh.p.k** kualifikohet me vlerë të ofruar:

- pa TVSH është **11.937.513,5** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e trebëdhjetë presje pesë) lekë.
- me TVSH është **14.325.016,2** (katërmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e pesë mijë e gjashëmbëdhjetë presje dy) lekë.

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **11.937.513,5** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e trebëdhjetë presje pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 30/10/2018

Gjatë afatit ligjor prej 7 ditësh për pritjen e ankesave nuk pati ankesa.

